



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE
KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

Nr. _____ Prot.

Tiranë më ____ . ____ . _____

PROCES - VERBAL

**Anëtarët e shoqërisë civile të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC)
takim për organizimin e konsultimeve dhe
për përzgjedhjen e kandidatave për ZëvendësKryetar të KKSHC-së**

Sot, më datë 4.12.2017, mbahet ky proces - verbal mbi takimin e anëtarëve të shoqërisë civile të KKSHC-së, i zhvilluar pranë ambienteve të Qendrës së Informimit të Bashkimit Evropian Tiranë.

PJESA E PARË

***Organizimi i konsultimeve dhe procedura e përzgjedhjes së kandidatave për
ZëvendësKryetar të KKSHC-së***

Takimi fillon në orën 13:15.

Në takim marrin pjesë anëtarët e KKSHC-së:

1. Znj. Zana Vokopola
2. Z. Luan Ahmetaj
3. Z. Ergys Gezka
4. Z. Vladimir Thanó
5. Z. Blendi Dibra
6. Znj. Emanuela Zaimi
7. Znj. Mirela Koci

Pjesëmarrës nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC):

1. Znj. Ina Gjini
2. Znj. Paula Bero
3. Z. Andi Luga
4. Z. Ferhat Aga
5. Znj. Mimoza Çorbaxhi

Në takim gjithashtu morën pjesë ekspertë të BE-së:

1. Z. Max Fras
2. Znj. Christine Leiser



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE
KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

13:16 - Takimi prezantohet nga z. Max, i cili iu uroi mirëseardhjen gjithë të pranishmëve dhe i falënderoi për prezencën. Më tej prezantoi çështjet që do të diskutohen si:

- Organizimi i konsultimeve me përfaqësuesit e OSHC-ve rreth nëntë prioritetëve të Udhërrëfyesit (RoadMap), që do të zhvillohen në disa rajone të vendit;
- Përzgjedhja e kondidaturës për ZëvendësKryetar të KKSHC-së;

Në vazhdim z. Max dha disa sqarime mbi mënyrën se si do të organizohen konsultimet në rrethe si Vlorë, Tiranë, Shkodër dhe Korçë. Ai, gjithashtu, iu kërkoi anëtarëve të KKSHC-së, përfaqësues të shoqërisë civile të japin ndihmesën e tyre në organizimin dhe drejtimin e këtyre konsultimeve.

Ai u shpreh se se një rol ndihmës në këto konsultime do të japë dhe AMSHC-ja, si Sekretariat i KKSHC-së.

Pastaj z. Max sqaroi procesin e përzgjedhjes së Zv./Kryetarit, i cili do të bëhet në fund të takimit. Ai tha se anëtarët mund të përzgjidhnin çdo njërin prej tyre madje dhe vetveten.

Një nga pjesëmarrësit ngriti problemin e të mos qenit prezent të të gjithë anëtarëve, por z. Thanò tha se në takimin paraardhës kanë rënë dakord që ata do të votojnë kur të vijnë në një kufi kohor deri në orën 17.00 pasi kanë impenjime të ndryshme dhe nuk mund të jenë prezent tani.

Znj. Vokopola përforcoi argumentin e mësipërm duke konfirmuar se herën e fundit anëtarët thanë se do të votojnë kur të vijnë në takim.

Gjithashtu u tha se do të jenë dy persona, një përfaqësues nga anëtarët e shoqërisë civile të KKSHC-së dhe një nga AMSHC që do të ndihmojnë procesin dhe se do të ishte e mira të bien dakord dhe të mbarojnë me këtë proces.

Znj. Vokopola ndërhyr në përsëri dhe thotë se z. Thanò do të përpiqet t'i telefonojë anëtarët e tjerë të Këshillit.

Z. Max kërkoi që ata të firmosin një listë dhe të vendosin orën se kur do të votojnë, por zn. Vokopola shprehet se ne nuk mund të vendosim se kur do të vijnë anëtarët e tjerë dhe le të vendoset mbas telefonatave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE
KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

Z. Max thotë - “Ne kemi opinione të ndryshme lidhur me këtë, por vendimi është i juaji.”

Znj. Luarasi, ndërhyr dhe u thotë të pranishmëve se duhej të largohej, sepse fillonte seanca parlamentare dhe se duhej të ishte atje.

Me tej z. Max vazhdon me çështjen e parë, Udhërrëfyesi (The RoadMap). Ai thotë se ka nxjerrë material nga ky dokument dhe e ka përgatitur për konsultimin me përfaqësuesit e OSHC-ve të Tiranës. Ai tha - “Konsultimi do të fillojë në orën 15.00 dhe disa prej anëtarëve së bashku me një përfaqësues nga zyra e Kryeministrit do të përshëndesin të ftuarit dhe të nisë takimi konsultativ, i cili do të përfundojë në orën 17.00.

Të pranishmit do të diskutojnë rreth nëntë prioritetëve të Udhërrëfyesit dhe do të punojnë me grupe. Do të ngrihen nëntë grupe pune për nëntë prioritetet, ku ju si anëtarë të KKSHC-së do të jeni pjesë e këtyre grupeve sipas fushave që përfaqësoni.

Në fund të konsultimit do të bëhet një përmbledhje si dhe do të dalin konkluzione. Po ashtu shumica prej jush duhet të jenë pjesë dhe e konsultimeve në rrethe. Kush do të jetë në Vlorë, Shkodër dhe Korçë?”

Caktohen përfaqësuesit për secilin rreth:

1. Vlorë - (z. Koçi, z. Dibra dhe z. Zaimi)
2. Shkodër - (z. Dibra dhe z. Thanu)
3. Korçë - (z. Thanu)

Z. Max thotë se konsultimet do të jenë të hapura për çdo të interesuar. Znj. Zaimi do të përkthejë diskutimin.

Më pas z. Max ndan nëntë përfaqësues për nëntë prioritetet, për të cilat do formohen nëntë grupet e punës:

- Prioriteti Nr. 1 - Znj. Luarasi
- Prioriteti Nr. 2 - Znj. Vokopola
- Prioriteti Nr. 3 - Z. Ahmetaj
- Prioriteti Nr. 4 - Z. Dibra
- Prioriteti Nr. 5 - Z. Gezka
- Prioriteti Nr. 6 - Znj. Koçi
- Prioriteti Nr. 7 - Z. Coka
- Prioriteti Nr. 8 - Z. Luga
- Prioriteti Nr. 9 - Z. Aga



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE
KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

PJESA E DYTË

Përzgjedhja e kandidatave për ZëvendësKryetar të KKSHC-së

Më datë 4 dhjetor 2017, pranë ambienteve të Qendrës së Informimit të Bashkimit Evropian Tiranë, u krye procesi për përzgjedhjen e kandidatave për ZëvendësKryetar të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC).

Komisioni i ngritur për këtë qëllim, i miratuar nga anëtarët e pranishëm të KKSHC-së, u përbë nga z. Vladimir Thanó - në emër të KKSHC-së dhe nga z. Andi Luga - si përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC).

Prezenca për votim e anëtarëve të shoqërisë civile të KKSHC-së:

1. Znj. Iris Luarasi
2. Z. Ali Coka
3. Znj. Mirela Koçi
4. Z. Vladimir Thanó
5. Z. Blendi Dibra
6. Znj. Emanuela Zaimi
7. Znj. Zana Vokopola
8. Z. Ergys Gezka
9. Z. Luan Ahmetaj

15:15. Filloi procesi i votimit

17:00. Në përfundim të votimit të fshehtë, rezultuan:

- 10 (dhjetë) vota të vlefshme
- 1 (një) votë e pavlafshme, pasi në të shkruhej "Abstenoj"

Nga procesi i numërimit të votave të vlefshme, rezultoi:

- | | |
|----------------------------|--------------|
| 1. Z. Blendi Dibra..... | 3 (tre) vota |
| 2. Z. Ergys Gezka..... | 3 (tre) vota |
| 3. Z. Altin Hazizaj..... | 1 (një) votë |
| 4. Z. Ali Coka..... | 1 (një) votë |
| 5. Znj. Iris Luarasi..... | 1 (një) votë |
| 6. Znj. Zana Vokopola..... | 1 (një) votë |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE
KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

Në votim morën pjesë:

1. Znj. Iris Luarasi
2. Z. Ali Coka
3. Znj. Mirela Koçi
4. Z. Vladimir Thanó
5. Z. Blendi Dibra
6. Znj. Emanuela Zaimi
7. Znj. Zana Vokopola
8. Z. Ergys Gezka
9. Z. Luan Ahmetaj

Pranuan me votim duke deleguar votën:

1. Znj. Afërdita Seiti – *ia delegoi z. Vladimir Thanó dhe znj. Zana Vokopola*
2. Z. Altin Hazizaj – *ia delegoi z. Andi Luga*

Nuk morën pjesë në votim:

1. Znj. Artemisi Shehu
2. Znj. Erisa Lame

17:05. Meqenëse nga votimi rezultoi se z. Blendi Dibra dhe z. Ergys Gezka kishin nga tri vota, antëtarët vendosën të kalohej në një votim të dytë të fshehtë për zgjedhur midis këtyre dy kandidaturave.

17:15. Filloi votimi i dytë i fshehtë për përzgjedhjen midis dy kandidaturave më të votuara, të z. Blendi Dibra dhe z. Ergys Gezka për Zv./Kryetar të KKSHC-së.

Në votim morën pjesë:

1. Z. Ali Coka
2. Znj. Mirela Koçi
3. Z. Vladimir Thanó
4. Z. Blendi Dibra
5. Znj. Emanuela Zaimi
6. Znj. Zana Vokopola
7. Z. Ergys Gezka
8. Z. Luan Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE
KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

Pranuan me votim duke deleguar votën:

1. Znj. Afërdita Seiti – *ia delegoi z. Vladimir Thano*
2. Z. Altin Hazizaj – *ia delegoi z. Andi Luga*
3. Znj. Iris Luarasi – *ia delegoi z. Andi Luga*

Nuk morën pjesë në votim:

1. Znj. Artemisi Shehu
2. Znj. Erisa Lame

17:55. Në përfundim të votimit të dytë, rezultuan 11 (njëmbëdhjetë) vota të vlefshme.

Nga procesi i numërimit të votave të vlefshme, rezultoi:

1. Z. Blendi Dibra..... 8 (tetë) vota
2. Z. Ergys Gezka..... 3 (tre) vota

18:00. Komisioni i ngritur për procesin e përzgjedhjes me votim të kandidatave për ZëvendësKryetar të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC) shpallën fitues kandidaturën e z. Blendi Dibra.

18:05. Procesi i përzgjedhjes së kandidatave për Zv./Kryetar të KKSHC-së mbyllet.

Komisioni për përzgjedhjen e kandidaturës për Zv./Kryetar të KKSHC-së:

Z. Andi Luga

Përfaqësues nga AMSHC

Z. Vladimir Thano

Përfaqësues nga KKSHC